



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Duke u bazuar në nenin 25, paragrafi 3 dhe paragrafi 5 i Ligjit nr.06/L-092 Për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në mbështetje të nenit 11 dhe 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kryetari i Komunës, me datë 20.05.2025 miraton këtë :

V E N D I M

1. APROVOHET për shqyrtim të mëtutjeshëm kërkesa e Hisnije Halimi nga fsh.Zhegër, Komuna e Gjilanit e cila ka të bëjë me këmbimin e pronës së saj private me pronën komunale të cilat gjenden në kufij me njëra tjetrën me qëllim të rregullimit të infrastrukturës.
2. Këmbimi të kryhet në bazë të Elaboratit duke u bazuar në Ekstraktin nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrotje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.
3. Elaborati përfshinë pronat sipas tabelave të përshkruara nga evidenca kadastrale për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitës së tyre në kuadër të projektit për interes publik dhe sipërfaqeve të tyre të përshkruara në Elaborat për pronat të cilat shtrihen në territorin e Komunës së Gjilanit e i cili do të jetë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me Ndryshimet dhe Plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë -Sektori për çështje pronësoro juridike.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe protokolimit nga ana e Kryetrait të Komunës.

Alban HYSENI

Kryetar i Komunës



Zyra e Kryetarit | Komuna e Gjilanit
Rr. Bulevardi i Pavarësisë PN | Gjilan 60000 | Republika e Kosovës
Tel: +381 280 320 781 | <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> | Alban.Hyseni@rks-gov.net